



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1136/3 prot

Datë 09.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00058-04-04-2024, me objekt “Blerje artikuj ushqimor për shkollën speciale “3 Dhjetori” me fond limit 2,499,325.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër
- Ankimues:** Operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK me NIPT J66902033R dhe adresë: Lagjja “# Heronjte” Rruga Pal Engjelli, Zona Kadastrae 8593, nr pasurie 10/630 4001
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër me adresë: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër

Në datën 08.05.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.1136 prot., e operatorit ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00058-04-04-2024, me objekt “Blerje artikuj ushqimor për shkollën speciale “3 Dhjetori” me fond limit 2,499,325.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi me nr.1136 prot., datë 08.05.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

1-Oferta juaj rezulton anomalisht e ulet ne baze te formules se percaktuar ne DST si me poshte: Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur. Oferta juaj eshte me e ulet se 25% e fondit limit prandaj bazuar ne ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”I ndryshuar,neni 93,pika 5 ku thuhet: Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulë.

2- Martin Dede Vata subject mbeshtetes nuk rezulton i rregjistruar ne rregjistrin tregtar QKB ne kundershitim me LPP I ndryshuar neni 84.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri